

VENDIM
Nr.486, datë 23.6.2010

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.41, DATË 14.1.2009 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E DHËNIES SË LEJES SË KONCESIONIT
“ARMO”, SHA-SË, TIRANË, PËR PËRPUNIMIN E NAFTËS, GAZIT DHE TË
NËNPRODUKTEVE TË TYRE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, 12, pika 5, e 18, pika 2 të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në dokumentin e lejes së koncesionit, dhënë “Armo”, sha-së, Tiranë, për përpunimin e naftës, gazit dhe të nënprodukteve të tyre, bashkëlidhur vendimit nr.41, datë 14.1.2009 të Këshillit të Ministrave, të shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

““Armo”, sh.a. ndalohet t’u tregtojë produkte gjysmë të gatshme subjekteve, të cilat nuk zotërojnë lejet përkatëse të tregtimit ose impiantet përkatëse të përpunimit për këto gjysmëprodukte.”.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha